

Rezyme (Abstrakt i Zgjeruar për temë)

Titulli i punimit: Motivimit të nxënësve të shkollës së mesme të ulët për të nxënëit e shkencës

Autori: Emira Rashica Maloku

Mentori: Prof. Dr. Asoc. Fatlume Berisha

Programi: Specializim në mësimdhënie lëndore: Mësimdhënie e Kimisë

Viti akademik: 2025-2026

Data e mbrojtjes: 26.05.2026

Hyrje:

Tema e këtij studimi fokusohet në motivimin e nxënësve i cili është faktori kryesor për suksesin e tyre akademik dhe për cilësinë e të nxënëit.

Motivimi si komponent është jetik sidomos në lëndët shkencore. Kjo çështje në kontekstin aktual arsimor është bërë shqetsuese, sidomos pas rezultateve të publikuara nga testimi ndërkombëtar PISA, ku nxënësit nga vendi ynë renditen ndër më të dobëtit në lexim, matematikë dhe shkenca, ndonëse faktorë janë të shumtë e një nga ta që ndikon në këtë performancë të ulët është mungesa e motivimit të brendshëm për të nxënë, veçanërisht në lëndët shkencore. Në nivel lokal ekziston një mungesë e të dhënave empirike që lidhin drejtpërdrejt orientimet motivuese me performancën specifike në lëndët shkencore në shkollat e mesme të ulëta. Shumica e studimeve fokusohen në aspektin e përgjithshëm pedagogjik.

Në teorit bashkëkohore të edukimit motivimi kuptohet si forca që e shtyn individin të ndërmarrë veprime drejt një qëllimi të caktuar. Morris et al. (2022) theksojnë se sjelljet motivuese janë vendimtare për arritjet akademike, pasi ato përcaktojnë përpjekjen, vlerësimin dhe angazhimin e nxënësve. Gjithashtu, sipas Gbollie dhe Keamu (2017), nxënësit që janë të motivuar kanë më shumë gjasa të tregojnë interes, të përfshihen në mënyrë aktive dhe të arrijnë rezultate të kënaqshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në lëndët shkencore, të cilat kërkojnë përfshirje aktive, mendim kritik dhe zbatim praktik të njohurive.

Pyetjet hulumtimit ishin:

1. A janë nxënësit e shkollave të mesme të ulëta të motivuar për të nxënëit e fushës së shkencës?
2. Në çfarë mënyre ndryshojnë orientimet motivuese të nxënësve të shkencave sipas gjinisë?

Metodologjia :

Ky hulumtim ka një qasje kuantitative dhe një dizajn përshkrues dhe korelacional, ku është synuar për trajtim jo vetëm pasqyrimi i gjendjes aktuale të motivimit të nxënësit, por edhe identifikimi i lidhjeve ndërmjet variablave kryesore, si metodat mësimore, qëndrimet ndaj shkencës. Hulumtimi

është realizuar me anë të një pyetësoi të cilin e kemi modifikuar nga pyetësoi: Students' Attitudes and Motivation to Study Chemistry Questionnaire (Pyetësoi për Qëndrimet dhe Motivimi i Studentëve për të Studiuar Kimi), pyetësoi është i adaptuar bazuar në SMQ-II dhe instrumente të tjera. Ky pyetësor është valid përdoret për të mbledhur informacion rreth ndjenjave mbi shkencën në shkollë. Pyetësoi është modifikuar për t'iu përshtatur kontekstit të nxënësve të shkollës së mesme të ulët dhe përbëhet nga pesë pjesë.

Rezultatet e të dhënave:

Rezultatet janë marrë nga përgjigjet e nxënësve. Pasi është bërë mbledhja e pyetësorëve, është dashur të mblidhen të dhënat dhe të vendosen në SPSS për analiza të mëtejshme. Rezultatet e korrelacionit për mostra të pavarura, të cilat krahasojnë dallimet mes gjinive të nxënësve në lidhje me motivim për lënden e Kimisë. Në mënyrë të detajuar, gjinia nuk shfaq lidhje të rëndësishme me asnjë prej variablave të tjerë ($r = .098$ me moshën, $r = -.041$ me shkollën, $r = .037$ me klasën; të gjitha me $p > .05$). Mungesa e korrelacionit domethënës ndërmjet gjinisë dhe variablave të tjerë ($r = .037, p > .05$) sugjeron se në këtë hulumtim, perceptimet për kiminë dhe motivimi nuk ndikohen nga faktori gjinor. Kurse teoria Eccles argumenton se si djemtë dhe vajzat i shohin lëndët shkencore ndryshe. Analiza e variancës (ANOVA) për variablat që ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi faktorët që ndikojnë në dallimet mes grupeve të nxënësve. Të dhënat tregojnë se vetëm mosha ka një ndikim të rëndësishëm, ndërsa gjinia, shkolla dhe klasa nuk shfaqin dallime statistikisht të vlefshme. Në të gjitha dimensionet e testuara, vlera e signifkancës (p) rezultoi më e lartë se niveli kritik .05.

Diskutimi:

Punimi në fjalë është i bazuar në dy pyetje kërkimore të formuluar në pjesën e qëllimit të studimit dhe metodologjisë. Përmes një instrumenti të rëndësishëm siç është pyetësoi, është bërë e mundur grumbullimi i të dhënave të vlefshme dhe gjithëpërfshirëse që ndihmojnë në analizimin dhe interpretimin e çështjeve që trajtohen në këtë temë. Ky studim ka synuar të analizojë motivimin, qëndrimet dhe interesin e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta ndaj lëndëve shkencore, veçanërisht kimisë, dhe perspektivat e tyre për të ardhmen shkencore. Në lidhje me pjesën e parë kërkimore që ka të bëjë me pjesëmarrjen demografike dëshmojnë se pjesëmarrësit në këtë hulumtim kanë një shpërndarje gjeografike të ndryshme. Nga 114 nxënës pjesëmarrës në hulumtim, 54 janë femra (47.4%) dhe 60 meshkuj (52.6%).

Sa i përket nxënësve, rezultatet tregojnë një shpërndarje të larmishme: Nga shkolla fillore e mesme e ulët Bislim Imeri janë 32 pjesëmarrës apo 28.1%, Shkolla fillore e mesme e ulët Hajrullah Shala janë

33 pjesemarres apo 28.9%, shkolla fillore e mesme e ulet Lumni Surdulli jane 27 pjesemarres apo 23.7%, shkolla fillore e mesme e ulet Fazli Greiqefci jane 22 pjesemarres apo 19.3%.

Në lidhje me pjesen e dytë kërkimore që ka të bëjë me ndjenjat e nxënësve për shkencën në shkollë theksojmë se respondentët kanë dhënë përgjigjeje të ndryshme ku vërejmë se kimia perceptohet si sfiduese, shumica e nxënësve shfaqin interes dhe lidhje me jetën reale, duke sugjeruar se motivimi i brendshëm është i pranishëm. Të dhënat statistikore tregojnë se as gjinia, as klasa dhe as shkolla nuk kishin ndikim statistikisht të rëndësishëm në motivim ($p > .05$). Në ky rezultat shohim se mjedisi shkollor dhe metodat e mësimdhënies luajnë një rol më uniform sesa origjina apo gjinia e nxënësve. Për shembull, pyetjet që lidhen me pritjen dhe kënaqësinë gjatë orëve të kimisë tregojnë mesatare nga 1.70 deri 3.31, me devijime standarde që tregojnë një variacion mesatar. Nxënësit që ndihen mirë kur kuptojnë konceptet ($M = 1.72$) tregojnë se ekziston një kënaqësi kur arrihet kuptimi, ndërsa disa nxënës nuk e shohin mësimin e kimisë si tërheqës ($M = 3.31$), duke reflektuar një nivel motivimi të ndryshëm brenda grupit. Kjo tregon se disa nxënës e perceptojnë kiminë sfiduese, por sfida nuk duket të ndikojë negativisht në motivim. Rezultatet treguan se nxënësit gëzojnë një nivel të lartë të motivimit të brendshëm, ku ndjenja e kënaqësisë gjatë kuptimit të koncepteve ($M=1.72$) dhe besimi në suksesin individual ($M=1.70$) dominojnë. Sipas teorisë së Bandura-s, ky vetë-efikasitet i lartë është jetik, pasi parashikon angazhimin e nxënësve edhe përballë detyrave sfiduese.

Perfundimet dhe rekomandimet:

Bazuar në të dhënat e nxjerra nga ky hulumtim empirik, mund të konstatojmë se zbatimi i motivimit në klasë, në shkollat tona nuk është në nivelin e dëshiruar. Siç evidentohet edhe nga përgjigjet e nxënësve, motivimi i tyre për të mësur shkencë dhe format e motivimit nuk janë të përfaqësuara në mënyrë të mjaftueshme në lëndët shkencore përkatëse e veq mas në kimi ku ishte fokusi i këtij hulumtimi. Bazuar në të dhënat e nxjerra nga ky hulumtim empirik, mund të konstatojmë se zbatimi i motivimit në klasë, në shkollat tona nuk është në nivelin e dëshiruar. Siç evidentohet edhe nga përgjigjet e nxënësve, motivimi i tyre për të mësur shkencë dhe format e motivimit nuk janë të përfaqësuara në mënyrë të mjaftueshme në lëndët shkencore përkatëse e veq mas në kimi ku ishte fokusi i këtij hulumtimi.

Fjalë kyçe: *motivimi, mësimdhënia, të nxënësve, shkencë, kimia.*

Resume (Extended Abstract for topic)

Title of the paper: Motivation of lower secondary school students for learning science

Author: Emira Rashica Maloku

Mentor: Prof. Dr.Asoc. Fatlume Berisha

Program: Specialization in subject teaching: Chemistry Teaching

Academic year: 2025-2026

Defense date: 26.05.2026

Introduction:

The topic of this study focuses on student motivation, which is the main factor for their academic success and the quality of learning.

Motivation as a component is vital, especially in science subjects. This issue in the current educational context has become a concern, especially after the results published by the international PISA test, where students from our country are ranked among the weakest in reading, mathematics and science, although there are many factors and one of them that influences this low performance is the lack of internal motivation to learn, especially in science subjects. At the local level, there is a lack of empirical data that directly links motivational orientations to specific performance in science subjects in lower secondary schools. Most studies focus on the general pedagogical aspect. In contemporary educational theory, motivation is understood as the force that pushes the individual to take action towards a certain goal. Morris et al. (2022) emphasize that motivational behaviors are crucial for academic achievement, as they determine the effort, appreciation and engagement of students. Also, according to Gbollie and Keamu (2017), students who are motivated are more likely to show interest, be actively involved, and achieve satisfactory results. This is especially important in science subjects, which require active involvement, critical thinking, and practical application of knowledge.

The research questions were:

1. Are lower secondary school students motivated to learn science?
2. How do science students' motivational orientations differ by gender?

Methodology:

This research has a quantitative approach and a descriptive and correlational design, where it is intended to address not only the current state of students' motivation, but also to identify the connections between key variables, such as teaching methods, attitudes towards science. The research was conducted using a questionnaire that we modified from the Students' Attitudes and Motivation to Study Chemistry Questionnaire, the questionnaire is adapted based on the SMQ-II and other instruments. This questionnaire is valid and is used to collect information about feelings about science

in school. The questionnaire was modified to fit the context of lower secondary school students and consists of five parts.

Data Results:

The results were obtained from the students' responses. After the questionnaires were collected, the data had to be collected and entered into SPSS for further analysis. Correlation results for independent samples, which compare the differences between the genders of students regarding motivation for the subject of Chemistry. In detail, gender does not show significant relationships with any of the other variables ($r = .098$ with age, $r = -.041$ with school, $r = .037$ with grade; all with $p > .05$). The lack of significant correlation between gender and other variables ($r=.037, p>.05$) suggests that in this research, perceptions of chemistry and motivation are not influenced by gender. While Eccles theory argues that boys and girls see science subjects differently. Analysis of variance (ANOVA) for variables that provide a clear insight into the factors that influence the differences between groups of students. The data show that only age has a significant impact, while gender, school and class do not show statistically valid differences. In all dimensions tested, the significance value (p) resulted higher than the critical level .05.

Discussion:

The paper in question is based on two research questions formulated in the purpose of the study and methodology section. Through an important instrument such as the questionnaire, it has been possible to collect valid and comprehensive data that help in the analysis and interpretation of the issues addressed in this topic. This study aimed to analyze the motivation, attitudes and interest of lower secondary school students towards science subjects, especially chemistry, and their perspectives for the scientific future. Regarding the first research part that deals with demographic participation, it is evident that the participants in this research have a different geographical distribution. Of the 114 students participating in the research, 54 are female (47.4%) and 60 are male (52.6%).

Regarding the students, the results show a diverse distribution: From the Bislim Imeri primary and lower secondary school there are 32 participants or 28.1%, Hajrullah Shala primary and lower secondary school there are 33 participants or 28.9%, Lumni Surdulli primary and lower secondary school there are 27 participants or 23.7%, Fazli Greiqefci primary and lower secondary school there are 22 participants or 19.3%.

Regarding the second part of the research, which is related to the feelings of students about science at school, we emphasize that the respondents have given different answers, where we note that

chemistry is perceived as challenging, most students show interest and connection with real life, suggesting that intrinsic motivation is present. Statistical data show that neither gender, nor class, nor school had a statistically significant impact on motivation ($p > .05$). In this result we see that the school environment and teaching methods play a more uniform role than the origin or gender of the students. For example, questions related to expectations and satisfaction during chemistry lessons show means from 1.70 to 3.31, with standard deviations showing a moderate variation. Students who feel good when they understand the concepts ($M = 1.72$) indicate that there is a satisfaction when understanding is achieved, while some students do not find chemistry learning attractive ($M = 3.31$), reflecting a different level of motivation within the group. This indicates that some students perceive chemistry as challenging, but the challenge does not seem to negatively affect motivation. The results showed that students enjoy a high level of intrinsic motivation, where the feeling of satisfaction when understanding the concepts ($M = 1.72$) and belief in individual success ($M = 1.70$) dominate. According to Bandura's theory, this high self-efficacy is vital, as it predicts students' engagement even in the face of challenging tasks.

Conclusions and recommendations:

Based on the data obtained from this empirical research, we can conclude that the implementation of motivation in the classroom, in our schools is not at the desired level. As evidenced by the students' responses, their motivation to learn science and the forms of motivation are not sufficiently represented in the relevant scientific subjects, especially in chemistry, which was the focus of this research. Based on the data obtained from this empirical research, we can conclude that the implementation of motivation in the classroom, in our schools is not at the desired level. As evidenced by the students' responses, their motivation to learn science and the forms of motivation are not sufficiently represented in the relevant scientific subjects, especially in chemistry, which was the focus of this research.

Keywords: motivation, teaching, learning, science, chemistry.